

# **Mbrojtja e Mjedisit – Mbështetja e LevizAlbania**

Përgatitur nga: Olsi Nika

## Përmbajtja e lëndës

<b>Lista e grafikëve</b> .....	<b>1</b>
<b>Hyrje</b> .....	<b>2</b>
<b>Çfarë është LevizAlbania?</b> .....	<b>2</b>
<b>Mbështetja e LevizAlbania për Mjedisin</b> .....	<b>3</b>
<b>RASTI STUDIMOR 1: Fushata të vazhdueshme për mbrojtjen e mjedisit</b> .....	<b>5</b>
<b>RASTI STUDIMOR 2: Ndryshimi i mendësisë</b> .....	<b>7</b>
<b>RASTI STUDIMOR 3: Përmirësimi i qeverisjes vendore mjedisore – ndërlidhja e llogaridhënies me bashkëpunimin</b> .....	<b>9</b>
<b>Nga trashëgimia tek fuqizimi</b> .....	<b>11</b>
<b>Përfundime</b> .....	<b>13</b>

## Lista e grafikëve

**Grafiku 1:** Projektet mjedisore të mbështetura nga LevizAlbania përgjatë 2015-2022... 4

**Grafiku 2:** Projektet e mbështetura nga LA në fushën e mjedisit, të ndarë në grupime... 5

**Grafiku 3:** Shpërndarja gjeografike e projekteve mjedisore të mbështetura nga LA.....11

# Hyrje

## Çfarë është LevizAlbania?

LevizAlbania është një projekt që synon forcimin e demokracisë lokale në Shqipëri, përmes angazhimit dhe fuqizimit të organizatave të shoqërisë civile, grupeve informale dhe individëve si kampion demokracie. LevizAlbania mbështet demokracinë vendore në të gjithë vendin, duke kultivuar një shoqëri civile në nivel vendor, e cila rrit kërkesën për qeverisje të mirë në nivel vendor përmes:

- *Vendimmarrjes gjithpërfshirëse*
- *Monitorimit të qeverisjes vendore*
- *Transparencës*
- *Përgjegjshmërisë*
- *Llogaridhënies*
- *Monitorimit të cilësisë së shërbimeve publike*

Përmes LevizAlbania aktorët e shoqërisë civile mund të sjellin dhe të aplikojnë ide konkrete për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që kanë interes për komunitetin e tyre. Skema e granteve është vënë në zbatim përmes thirrjeve periodike për aplikime.

Ndërhyrja e Shpejtë është një tjetër instrument i rëndësishëm i LevizAlbania, që ka mbështetur nisma të organizatave të shoqërisë civile dhe individëve, lidhur me kauza apo çështje emergjente që ndikohen nga faktori kohë. Ndërhyrja e Shpejtë ka qenë një mundësi për të adresuar nevojën për ndërhyrje emergjente përmes aksionit qytetar. Aplikimet në Ndërhyrjen e Shpejtë (më poshtë referuar edhe si NSH) trajtohen me një procedurë të thjeshtuar, për t'iu përgjigjur në kohë dhe në të mirë të çështjes/kauzës.

LevizAlbania (më poshtë referuar edhe si LA) ka ndërmarrë projekte strategjike dhe advokim në nivel kombëtar për të mundësuar një mjedis të favorshëm për përmirësimin dhe qëndrueshmërinë e demokracisë vendore, me synimin për të ndikuar axhendën kombëtare. Kjo përfshin mbështetje për organizata e koalicione të konsoliduara për të adresuar ndryshime sistemike.

LevizAlbania financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nga një konsorcium i tre organizatave të suksesshme shqiptare: "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Bashkëpunim" dhe "Co-PLAN – Instituti për Zhvillimin e Habitatit".

## Një udhëtim ndër vite

LevizAlbania nisi rrugëtimin e saj në mesin e vitit 2015 kur u ngrit ekipi i projektit dhe u shpall thirrja e parë për aplikime.

Që në fillim, projekti u mirëprit nga komuniteti i Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), që iu përgjigj thirrjeve për aplikime me interes të shtuar. LA solli një qasje inovative, përmes aplikimit të mekanizmave të ndryshëm, që synonin mbulimin e një game të gjerë fushash veprimi, për të arritur objektivin përfundimtar që ka ndjekur projekti përgjatë këtyre viteve: "Demokracia Lokale në Veprim".

Që në fillim, LevizAlbania është udhëhequr nga parimi i gjithpërfshirjes. Mbështetja e individëve dhe grupeve informale ka qenë një nga karakteristikat e LA, e sjellë si një risi, që u transformua më pas në një model autentik për t'iu replikuar nga donatorë të tjerë në Shqipëri.

"Konkursi i Ideve" ka qenë një tjetër qasje inovative e sjellë në një mënyrë mjaft origjinale nga LevizAlbania, në përmbushje të parimit të transparencës. Konkursi i Ideve ka shërbyer gjithashtu, në mjaft raste, si një forum për shkëmbimin e përvojave dhe rrjetëzim mes organizatave aplikuese.

Krijimi i instrumentave mbështetës për organizatat, grupet informale dhe individët, përfshirë në thirrjet e ndryshme për aplikime, ka ndihmuar këto të fundit me një mjedis më mundësues për arritjen e objektivave të projekteve të veçanta.

Në këtë kontekst, LevizAlbania zhvilloi tre mekanizma kyç të mbështetjes: **i) Financat Vendore** që shërbeu si bazë të dhënash dhe një pikë reference në adresimin e çështjeve të transparencës dhe monitorimin e standardeve të qeverisjes vendore; **ii) Porta Vendore** që ka shërbyer si një dritare informuese për të fuqizuar median vendore në adresimin e çështjeve të identifikuar nga grantmarrësit e LA dhe nga qytetarët; **iii) Klinika e Ligjit** që gjithashtu ka qenë instrument efektiv i mbështetjes, që është përdorur shpesh nga grantmarrësit e LA në proceset gjyqësore. Ky instrument u kthye në një faktor ndryshimi i fushatave të advokimit dhe lobimit.

Nga 2015 deri në fund të vitit 2022 LA ka shpallur 9 Thirrje për Aplikime, ka mbështetur 12 Grante Strategjike, 23 projekte NSH, 362 individë, grupe informale dhe OSHC, si dhe më shumë se 75,000 qytetarë të përfshirë në këto projekte.


Rreth 40% e aktorëve civilë të mbështetur, vijojnë të çojnë përpara nisma në dobi të komuniteteve vendore edhe pas përfundimit të mbështetjes, duke sjellë prova konkrete të ndikimit të qëndrueshëm<sup>1</sup>.

### Mbështetja e LevizAlbania për Mjedisin

Edhe pse mjedisi nuk është fokusi i LevizAlbania, që në fillim, LA ka mbështetur nisma dhe aksione që kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjes qytetare mbi mjedisin, si dhe veprime që kanë të bëjnë me ruajtjen e mjedisit përmes nxitjes së angazhimit qytetar me qasje pjesëmarrëse.

Një mjedis i pastër, i shëndetshëm dhe i qëndrueshëm ka qenë fokusi i shumë nismave të mbështetura nga LevizAlbania. Për më tepër, duke qenë një fushë ndërdisiplinore, mjedisi shpesh është i ndërthurur me proceset më themelore të demokracisë, si e drejta e informimit, qasja në vendimarrje, apo akses i drejtësi për çështje mjedisore.

Në këtë këndvështrim, mbështetja e LevizAlbania për nisma apo projekte që synojnë ruajtjen e mjedisit ka ardhur duke u rritur deri në 68 nga 309 projekte gjithsej të mbështetura nga LA.



**Grafik 1:** Projekte mjedisore të mbështetura nga LevizAlbania përgjatë 2015-2022

Referuar Grafikut 1 më sipër, duket qartë trendi rritës i mbështetjes së LA për nisma dhe projekte që synojnë ruajtjen e mjedisit. Kjo mbështetje fillimisht synonte më së shumti nxitjen e nismave me bazë në komunitet si dhe atyre të lidhura me vendimarrjen vendore mjedisore. Në këtë kontekst, fillimisht,


<sup>1</sup> Zhulali, Floreta (2021) "Vlerësim i Jashtëm i Thirrjes për Aplikime Nr. 6 të LevizAlbania"; dhe Sulka, Kastriot (2022) "Vlerësim i Jashtëm i Thirrjes për Aplikime Nr. 7 të LevizAlbania"

mbështetja kishte një shtrirje të vogël gjeografike dhe mbulim sporadik të çështjeve mjedisore. Megjithatë, nevoja për disa ndërhyrje përmes advokimit dhe fushatave ndërgjegjësuese për çështje shumë të mprehta mjedisore, ndërthurur me një paketë procedurash për grantdhënie inovative, transparente, dhe mjaft lehtësuese nga LA, kanë bërë që gjithnjë e më shumë organizata mjedisore të aplikojnë për mbështetje nga LA.

Konsolidim i ndjeshëm është vënë re edhe në thirrjet për **grante strategjike**, ku projektet mjedisore kanë zënë një peshë të madhe. Për më tepër, orientimi drejt bashkëpunimit, ngritja e çështjeve në një nivel tjetër dhe lobimi për një arritje më të gjerë e më të fortë të publikut, kanë sjellë një përfaqësim më të madh e më të rëndësishëm të çështjeve mjedisore dhe të proceseve demokratike të lidhura me to.

Duke qenë se ndërhyrjet mjedisore dhe dëmtimet e natyrës janë shpesh të pakthyeshme, kërkohet një vigjilencë më e lartë mjedisore dhe aftësi për të reaguar në kohë për të parandaluar dëmtimet. Shpesh, mekanizmat e skemave të granteve dhe mbështetjes janë të ngadalta për të mundësuar një vlerësim dhe dhënie të shpejtë të fondeve, duke e bërë të pamundur ngritjen e shpejtë të çështjeve dhe përgjigjen në rastet e projekteve të dëmshme për mjedisin.

Për të tejkaluar këtë vështirësi, **Mekanizmi i Ndërhyrjes së Shpejtë**, i sjellë si risi nga LevizAlbania, u kthye në një mjet efikas, veçanërisht për projekte të lidhura me mbrojtjen e mjedisit.



Ky mekanizëm ka mbështetur fushata publike për kundërshtimin e disa vendimmarrjeve që mund të dëmtonin mjedisin, si për shembull "Mbrojtja e Monumentit të Natyrës Kanionet e Osunit"<sup>2</sup>, "Ndal HEC-eve në Parkun Kombëtar Lurë-Mali i Dejës"<sup>3</sup> dhe "Ndal Urbanizimit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta"<sup>4</sup>.

Duhet theksuar fakti që shumica e projekteve mjedisore të mbështetura nga LevizAlbania prekin çështjet që lidhen me mjedisin urban, të ndjekura nga aksione për ruajtjen e mjedisit. Megjithatë, kur vjen puna te skema e instrumentit të Ndërhyrjes së Shpejtë, fushatat për mbrojtjen e mjedisit zënë pjesën më të madhe në projektet e mbështetura. Si përfundim, edhe pse nuk ka pasur fokus mjedisin, përgjatë tetë viteve, LevizAlbania ka qenë një nxitës i rëndësishëm i çështjeve të mprehta mjedisore në vend, duke kontribuar në adresimin e problematikave, duke ngritur e mbështetur kauzat, si dhe duke ndërtuar një mjedis mundësues dhe nxitur bashkëpunimin mes organizatave, grupeve informale e individëve të veçantë, si dhe duke ofruar mbështetje përmes instrumentave lehtësues si

Financat Vendore, Porta Vendore apo Klinikat e Ligjit.

<sup>2</sup><https://www.levizalbania.al/sq/nisma-te-mbeshtetura/reagimi-shpejte/mbrojtja-e-kanioneve-te-osunit-si-monument-i-natyres>

<sup>3</sup><https://www.levizalbania.al/sq/nisma-te-mbeshtetura/reagimi-shpejte/ndal-hec-eve-ne-parkun-kombetar-lure-mali-i-dejes>

<sup>4</sup><https://www.levizalbania.al/sq/nisma-te-mbeshtetura/reagimi-shpejte/stop-urbanizimit-te-parkut-kombetar-divjake-karavasta>

## RASTI STUDIMOR 1: Fushata të vazhdueshme për mbrojtjen e mjedisit

### *Fushata për Mbrojtjen e Lurë-Mali i Dejës*

Leviz Albania ka nisur fushata publike që kanë të bëjnë me ndërmarrjen e veprimeve konkrete e të drejtëpërdrejta për ruajtjen e ekosistemeve natyrore në Shqipëri. Siç u theksua në kapitullin 3.3, kjo lloj mbështetje ishte pjesë e pothuajse të gjitha thirrjeve të LA, përfshirë NSH.

Një nga fushatat që përdor shumë elementë përgjatë zhvillimit të saj, është fushata për mbrojtjen e Parkut Kombëtar Lurë-Mali i Dejës. Fushata ishte një kundërshtim i ndërtimit të Hidrocentraleve (më poshtë referuar edhe si HEC) në Zall-Gjoçaj. Zona ishte përfshirë zyrtarisht në Parkun Kombëtar të Lurës, me Vendimin e Qeverisë shqiptare të 2018 për zgjerimin e saj.

Ndërtimi i hidrocentraleve në Shqipëri nisi në vitin 2005, bazuar vetëm në kërkesën e rritur për energji. Por nuk ka patur asnjë studim strategjik gjithëpërfshirës. Hidrocentralet nuk kanë kufizime gjeografike dhe si rrjedhim mund të ngrihen në Zona të Mbrojtura. Në këtë drejtim, pothuajse një dekadë më pas, situata është përkeqësuar ndjeshëm, ndërsa në vitin 2018, hidrocentralet e planifikuara për t'u ndërtuar brenda Rrjetit të Zonave të Mbrojtura në Shqipëri tejkaluan 39% të HEC-eve të planifikuara në të gjithë vendin.

Zhvillimi në një mënyrë kaotike bëri që shumë shpejt, kompanitë e ndërtimit të përballëshin me kundërshtimin e fortë të komuniteteve lokale lidhur me ndarjen e të drejtave për përdorimin e ujit. Në këtë kontekst, pothuajse një dekadë pas fillimit të së ashtuquajturës “Stuhia e Digave” filloi të krijohej një lëvizje kundër digave. Kjo lëvizje nisi fillimisht në zona të kufizuara në Lumin Shkumbin dhe Lumin Vjosa, për t'u ndjekur më tej nga lëvizjet kundër digave në Lumin Valbona e shumë të tjerë. Kjo lëvizje ishte një reagim i mirëfilltë lokal kundër projekteve shkatërrimtare të hidrocentraleve, që lidhet në thelb me përdorimin e pabarabartë të burimeve natyrore.

Fushata për mbrojtjen e Parkut Kombëtar Zall-Gjoçaj nisi me vënien në lëvizje të komunitetit vendas, kundër ndërtimit të HEC-it, nga fundi i vitit 2018. Fillimisht komuniteti iu mohua aksesit në të dhënat zyrtare lidhur me projektin e ndërtimit të HEC-it. Me fillimin e ndërtimit, komuniteti vendas u vu në lëvizje, organizoi takime dhe u mbështet në OSHC-të në Tiranë, ndërkohë që bllokonte sheshin e ndërtimit, duke u ngujuar në një çadër, si një shprehje e hapur e kundërshtimeve ndaj vendimmarrësve. Kundërshtimi i komunitetit vendas filloi dalëngadalë të rritej, duke marrë trajtë më të strukturuar, kur bërthama e vogël e vendasve nga Zall-Gjoçaj nisi krijimin e një rrjeti me komunitete të tjera, OSHC, media, avokatë dhe donatorë.

Beteja ligjore nisi në Mars 2019. Komuniteti vendas paraqiti 5 padi të ndryshme gjyqësore në Gjykatën Administrative të Tiranës, duke kërkuar anulimin e HEC-eve. Pas një procesi gjyqësor të ngadaltë, për shkak të pandemisë Covid-19, përgatë rrugës ka patur beteja të humbura e të fituara. Përfundimisht, Gjykata e Lartë konfirmoi moslidhjen e HEC në rrjet për shkak se ai ishte ndërtuar brenda një Zone të Mbrojtur. Pavarësisht përfundimit të punimeve ndërtimore, hidrocentrali është ligjërisht i ndaluar të punojë, duke shkaktuar asgjë më shumë se sa dëmtime sociale e mjedisore.

Një gur tjetër suksesi i fushatës ka qenë veprimet e drejtëpërdrejta në terren. Këto veprime të koordinuara, mes rritjes së ndërgjegjësimit, vlerësimit shkencor të ndikimit të HEC-eve dhe protestave të larmishme kanë tërhequr mbështetjen e publikut dhe të medias mbi këtë çështje. U organizua një numër protestash në vendin ku është ngritur hidrocentrali, por edhe në kryeqytet. Vlerësimet e ekspertëve në vend, kanë treguar ndikimin negativ të hidrocentralit në mjedis. Më tej, mjaft tryeza, debate publike dhe në TV në mbështetje të kësaj çështje, janë bërë pjesë e transmetimeve në media të ndryshme kombëtare.

Fushata, gjithashtu përdori në mënyrë të shkëlqyer median sociale. Duke qenë të mbyllur për shkak të Covid-19, komuniteti i Zall-Gjoçaj e ktheu këtë kufizim në mundësi, duke gjetur dhe përdorur mënyra inovative se si të rritej presioni publik përmes medias sociale. Një mbledhje në zoom, u projektua përballë gjykatës, ndërsa protesta on-line dhe fjalimet dëgjoheshin me altoparlantë, duke denoncuar korrupsionin

e autoriteteve dhe duke mbështetur çështjen e Zall-Gjoçaj. Një fushatë tjetër on-line u mbajt për shprehjen e rëndësisë së Parkut Kombëtar Lurë-Dejë, duke theksuar rëndësinë e çështjes gjyqësore në vijim për zgjidhjen e rastit. U prodhuan gjithashtu një seri fletësh informuese, mesazhe video dhe dokumentarë për rritjen e ndërgjegjësimit publik.

Rëndësia e fushatave on-line për ndërtimin e një diskutimi politik shumështrësor, u theksua së tepërmi përgjatë pandemisë. Kjo i ndihmoi shumë aktivistët të mbështesnin forma të tjera veprimi përmes argumenteve të shkruajtura dhe vizive. Kjo ndihmoi gjithashtu në ndërtimin e një solidariteti më të fuqishëm dhe më të qëndrueshëm me aktivistë të tjerë, komunitete dhe organizata të tjera mjedisore.

Në këtë këndvështrim, fushata është një simbol i lëvizjeve që nisin të vogla, por me një vizion dhe me njerëz të përkushtuar, që janë të vendosur të arrijnë qëllimin, e që pastaj rriten, përfshijnë gjithmonë e më shumë njerëz dhe në fund mund të shërbejnë si një model i mirë për t'u ndjekur në raste të tjera.

**Fushata ishte një kombinim i suksesshëm i aksionit në terren, veprimeve ligjore dhe një qasje positive on-line, duke pasur këmbënguljen si shtyllë kryesore mbështetëse.**

Fushata pati një rëndësi të madhe në ngritjen e një modeli të qëndrueshmërisë së komunitetit për mbrojtjen e natyrës dhe për forcimin e proceseve demokratike. Roli i LevizAlbania në këtë fushatë ishte vendimtar, pasi e mbështeti lëvizjen në shumë mënyra.

Kjo fushatë ndryshoi qasjen e komunitetit në lidhje me angazhimin e tij në çështje mjedisore. Beteja ligjore shumëplanëshe ka qenë gjithashtu një hap i rëndësishëm përpara drejt zbulimit të shtigjeve të reja për mbrojtjen e të drejtave mjedisore. Si i tillë, ky rast në studim mund të mbahet si një prej rasteve më të plotësuar, sa i takon përdorimit të arsyeshëm të instrumentave të ndryshëm të demokracisë, siç janë: protestat, presioni mediatik, ankimmimet administrative dhe gjyqësore.

Përfundimisht, fushata është një model reference për ndryshimin e mendësisë dhe për reagimin ndaj vendimmarrjes që kërcënon të mirat publike.

Kjo mund të konsiderohet si një rast i pazakontë suksesi, që mund të shërbejë si model lidhur me praktikën e përdorura në një betejë ligjore për çështjet mjedisore. Strategjia e ndërtimit të disa fronteve të njëpasnjëshme përgjatë betejës ligjore, mbështetur nga presioni i publikut përmes protestave dhe fushatave në media, ka bërë që çështja gjyqësore të kalojë në të gjitha shkallët e gjyqësorit në një kohë relativisht të shkurtër. Ky përbën gjithashtu një sukses jo vetëm për çështjen në vetvete, por në një farë mënyre edhe për mënyrën se si mund të qasen çështje të caktuara në procese gjyqësore.

*"Ne e nisëm të vetëm betejën tonë për mbrojtjen e Parkut Kombëtar, por shpejt kuptuam se ne nuk do të mund t'ia dilnim ta fitonim të vetëm këtë betejë. LevizAlbania ka qenë një mbështetje e fortë në rrugëtimin tonë të gjatë, në të cilin kemi mësuar se çelësi i suksesit është këmbëngulja" Dhimiter Koleci, Zall-Gjoçaj Udhëheqës i komunitetit.*

## **Përfundime**

Fushata për mbrojtjen e parkut kombëtar Zall-Gjoçaj përbën një ndryshim në qasjen e veprimit komunitar, duke gërshetuar udhëheqjen me zotërimin e një çështje të caktuar mjedisore.

Shpirti bashkëpunues dhe qasja gjithëpërfshirëse mund të sigurojnë qëndrueshmëri dhe efektivitet. Gjithashtu, koordinimi, këmbëngulja dhe përdorimi i sa më shumë mjeteve që të jetë e mundur për të arritur objektivin, mund të jetë një formulë fituese përfshirëse së bashku të gjithë elementët e fushatës.

## RASTI STUDIMOR 2: Ndryshimi i mendësisë

### Nisma e Luleve

Projektet që synuan përmirësimin e mjedisit urban janë mbështetur shumë dhe fuqishëm nga LevizAlbania përgjatë gjithë këtyre viteve në të gjithë vendin. Shumë prej këtyre nismave kanë synuar të ndërhyjnë në politikat vendore, ndërgjegjësimin apo forcimin e politikave për çështje që prekin mjedisin urban. Shumë të tjera kanë qenë aksione më të vogla, konkrete të ndërmarra nga grupe qytetare në komunitet.

Një rast suksesi është shembulli i veprimeve të ndërmarra nga "Nisma e Luleve".

Nisma e Luleve është një nismë qytetare, që ka si qëllim nxitjen e aktivizmit qytetar dhe përgjegjësi kolektive, për të mirën e përbashkët. Ajo u ngrit në tetor 2018 nga një grup të rinjsh nga qyteti i Sarandës, i quajtur fillimisht "Dhuro një lule për Sarandën".

Ideja fillestare ishte investimi në zgjerimin e hapësirave të gjelbra, në bashkëpunim të ngushtë me qytetarët e thjeshtë. Hapësirat e gjelbra në Sarandë u ulën ndjeshëm përgjatë tridhjetë viteve të fundit, për shkak të ndërtimeve të shumta në qytet. Nisma u përqendrua në rritjen e numrit të luleve "Bougainville" apo "Lulet e Sarandës" të mbjella, siç është e njohur prej vitesh si lulja simbol e qytetit të Sarandës, e sjellë për herë të parë nga Naim Frashëri në qytetin bregdetar.

Ideja u mbështet masivisht brenda disa muajsh dhe përmes aktivizmit qytetar, u bë e mundur të mbilleshin rreth 500 Bougainville dhe qindra pemë të tjera dekorative. Në mars 2019, Saranda lulëzoi me pemë dhe ngjyra si rrjedhojë e angazhimit të qindra qytetarëve që iu bashkuan kësaj nisme. Në vitin 2019, nisma u formalizua me emrin "Nisma e Luleve".

*"Unë, gjithmonë kam besuar se është mirë të japësh ide për t'i bërë gjërat ndryshe, por është edhe më mirë t'i zbatosh disa nga këto në praktikë, që do të thotë, të përpiqesh të bësh opozitë qytetare përmes veprimeve konkrete, të tregosh se gjërat mund të ndryshohen edhe në shkallë të vogël. Ajo që ne bëmë ishte veçse të tregonim se duam një vend më të mirë." Adriatik Lapaj, Anëtar i "Nisma e Luleve".*

Përveç aksioneve në zonat urbane të qytetit të Sarandës, "Nisma e Luleve" tregoi se thellësitë e detit Jon nuk janë aq të pastra sa ç'mund të duken nga sipërfaqja. Në vjeshtën e vitit 2019, si pjesë e veprimtarive vullnetare për mbrojtjen e mjedisit, u ideua pastrimi i parë nënujor i tabanit të detit Jon, në gjirin e qytetit. Ideja e kësaj nisme, identifikoi gjithashtu edhe problemin e rradhës për qytetin e Sarandës, ku me mijëra goma dhe mbetje plastike qendronin prej vitesh në thellësitë e ujrave, pa asnjë lloj ndërhyrjeje nga ana e autoriteteve shtetërore apo qeverisjes vendore.

Projekti i pastrimit të detit nga "Nisma e Luleve" filloi në shtator 2019, mbështetur nga LevizAlbania. Vetëm gjatë fazës së parë u nxorrën nga tabani i detit 585 goma.

Gjatë periudhës maj – shtator 2020, projekti vijoi me aksione për pastrimin e detit në gjirin e Sarandës dhe Ksamil, që rezultuan në nxjerrjen e rreth 426 gomave dhe rreth 15 mijë bidona dhe kanaçe, përveç mbetjeve të tjera.

Në total numri i gomave të nxjerra nga tabani i detit, përgjatë dy viteve arriti në 1011 dhe 30,000 mbetje të tjera. Paralelisht me pastrimin, zhytësa vullnetarë identifikuan gjithashtu rreth 4000 goma të tjera në zona të reja të paeksploruara më parë, duke e rritur numrin e synuar të gomave për t'u nxjerrë nga thellësitë e detit Jon, nga 1000 në 4000 goma më shumë.

Duke qenë një nismë qytetare, projekti u mbështet kryesisht në veprimtari vullnetare. Nisma e Luleve vijoi me aksionet e pastrimit edhe pas përfundimit të mbështetjes nga LevizAlbania. Në këtë mënyrë, mund të konsiderohet një ndërhyrje e qëndrueshme dhe një model për përfshirjen e grupeve qytetare në veprime konkrete për të përmirësuar mjedisin urban.

Qysh prej fillimit të kësaj nisme, rreth 2100 goma dhe mijëra mbetje të tjera janë nxjerrë nga tabani i detit, në 30 veprimtari pastrimi të kryera deri tani nga Nisma e Luleve.



*"Lajmi i mirë është se pas katër vitesh të përkushtimit tonë, gjiri i Sarandës është tërësisht i pastër, pasi kemi nxjerrë mbi dy mijë goma dhe ndërkohë po vijojmë me Ksamilin, si dhe do të vijojmë edhe me Himarën gjithashtu. Qëllimi është të ndërgjegjësojmë shtetin, pasi kemi parë që qytetarët janë tashmë të ndërgjegjshëm në pjesën më të madhe dhe në zonat që ne kemi pastruar, kur kthehemi, nuk gjejmë më goma të hedhura në det" Adriatik Lapaj, Anëtar i "Nisma e Luleve".*

Duke njohur problematikat e bashkëjetesës në një mjedis të përbashkët, nisma përpiqet të sjellë modelin e saj të zgjidhjes dhe në sajë të veprimtarive konkrete të një grupi të shoqërisë civile, kjo nismë ka gjetur një mbështetje të gjerë nga qytetarët.

Përveç ndërgjegjësimin, nisma synon të propozojë një mënyrë të re të menaxhimit në Shqipëri, të mbetjeve që vijnë nga gomat, duke qenë se nuk ka një mënyrë të duhur për t'i trajtuar ato edhe pse çdo vit importohen 1.5 milion goma. Ka një kuadër ligjor të pamjaftueshëm dhe "Nisma e Luleve" është angazhuar të punojë me një grup juristësh për t'i propozuar Këshillit të Ministrave, ndryshimet e duhura në mënyrë që më në fund Shqipëria të ketë një sistem të vërtetë për gjurmimin e gomave që nga momenti i hyrjes në doganë deri në hapin përfundimtar të dërgimit të tyre në landfill.

Nisma, qartësisht e ka bërë këtë problem të dukshëm dhe për rrjedhojë komuniteti vendas ka një ide më të qartë mbi përmasat e ndotjes nënujore detare. Kjo çështje sjell një qasje të re se si duhen adresuar çështjet e përbashkëta të mjedisit. Angazhimi qytetar mbi baza vullnetare, tregon një ndryshim të rëndësishëm të mendësisë lidhur me ndotjen. Për më tepër, veprimet e vogla të komunitetit japin një shembull të mirë se, gjërat e mëdha mund të arrihen. Nisma jep një ndihmesë të madhe drejt vendosjes së modeleve të suksesshme, të cilat mund të ndiqen dhe replikohen në raste të tjera të ngjashme.

Përveç aksioneve konkrete, nisma po përmyll ciklin duke duke arritur edhe një ndryshim në politika, pasi ka nisur ndryshimet ligjore për përmirësimin e kuadrit rregullator që merret me trajtimin e gomave në fund të ciklit të tyre jetësor.

#### **Përfundime:**

Aksionet e pastrimit të ndërmarra nga "Nisma e Luleve" nuk janë të rastësishme. Natyra e veçantë e mjedisit që po pastrohet paraqet disa sfida dhe vështirësi të veçanta. Për më tepër, këmbëngulja dhe gjithëpërfshirja në këto veprimtari kanë bërë që të "pastrohet" një mendësi në sjellje e shoqërisë përkundrejt mjedisit, që është dëmtuar në këto 30 vitet e fundit.

Përqaftimi masivisht i kësaj nisme tregon se aksionet e vogla qytetare janë shembulli më i mirë për të nxitur një lëvizje qytetare pozitive, e cila mund të sjellë një ndryshim të madh në mendësi. Në këtë këndvështrim, kërkesa e llogarisë ndaj vendimmarrësve vjen më e natyrshme dhe më e vendosur, pasi mbështetet në të dhëna praktike se një gjendje e caktuar mund të ndryshohet nëse ka vullnet të fortë.

Qendrueshmëria në kohë, pavarësisht mbështetjes financiare, si dhe shtrirja dhe përqaftimi i kësaj nisme në zona të tjera bregdetare, përgjatë viteve, provon se aktivizmi në bazë është një model i suksesshëm dhe funksional, që vlen të mbështetet e të nxitet më tej.

## **RASTI STUDIMOR 3: Përmirësimi i Qeverisjes Vendore Mjedisore – ndërlidhja e llogaridhënies me bashkëpunimin**

*Barometri i Bashkisë Devoll. Matja e premtimeve zgjedhore të qeverisjes vendore sipas nenit 27. Funksionet e bashkisë në bujqësi, zhvillimin rural dhe pyje.*

Një nga fushat specifike të sektorit të mjedisit është ndërhyrja për përmirësimin e politikave mjedisore në nivel vendor përmes bashkëpunimit dhe llogaridhënies. Reforma Territoriale e viteve 2014-2015 në Shqipëri, që u përmbyll me miratimin e Ligjit 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", krijoi një realitet të ri për Njësitë e Qeverisjes Vendore. Krijimi i Bashkive të reja, që përfshinin një territor më të madh në administrim dhe një numër kompetencash të reja, ishte një nga sfidat kryesore për zbatimin e kësaj reforme.

Fushat e mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit rural, menaxhimit të pyjeve, bujqësia, etj., do të qeveriseshin tashmë vetëm prej Bashkive të reja. Në shumë raste, veçanërisht bashkitë e vogla, nuk ishin mjaftueshëm të përgatitura për shkak të burimeve të kufizuara financiare dhe njerëzore për të administruar sektorët e rinj. Në disa bashki u krijuan struktura të reja, që rezultuan të ishin joeficiente në përmbushjen e kompetencave të reja. Ndaj, adresimi i këtyre çështjeve ishte një sfidë e jashtëzakonshme. Matja e nivelit dhe mënyrës se si këto çështje adresoheshin përbënte gjithashtu një sfidë më vete.

Në këtë kontekst, Projekti "Barometri i Bashkisë Devoll" është një prej shembujve më të mirë për t'u konsideruar si rast suksesi. Projekti u zbatua nga Qendra Shqiptare për Qeverisje Mjedisore (ACEG) gjatë periudhës 2018-2019, si pjesë e Thirrjes nr. 5 të LevizAlbania.

Qendra Shqiptare për Qeverisje Mjedisore (ACEG) është një organizatë joqeveritare e themeluar në mars 2016, me qëllim nxitjen e vlerave të qeverisjes mjedisore, zhvillimin e agroturizmit në këtë drejtim, drejtësinë mjedisore dhe ekonominë e gjelbër. Që prej krijimit, Qendra ACEG ka përqendruar veprimtarinë e vet në Devoll dhe në njësitë administrative të tij, duke punuar si një organizatë me bazë dhe me lidhje të forta në komunitet. Qendra ACEG është një avokat i fortë i zonës dhe punon për të bindur vendimmarrësit të ndërmarrin zgjidhjet inovative që kjo qendër propozon.

Projekti "Barometri i Bashkisë Devoll" përbëhet nga 3 elementë bazë:

- Mbledhja dhe analizimi i angazhimeve zgjedhore në fushatën e zgjedhjeve të vitit 2015.
- Vlerësimi i performancës së qeverisjes vendore në periudhën 2015-2018, në 5 çështje të veçanta.
- Hartimi i Dokumentit të Përparësive të Qeverisjes Vendore për Mandatin e ardhshëm Qeverisës të Bashkisë.

Ndërtuar mbi një metodologji përfshirëse dhe me pjesëmarrje, projekti arriti të ndërthurë me vërtetësi kërkesën e llogarisë me pjesëmarrjen përkundrejt qeverisjes vendore. Metodologjia e zbatuar nënkupton një qark të mbyllur dhe vlerësim profesional të performancës së qeverisjes, që mund të ripërsëritet nga një mandat në tjetrin, si dhe të merret edhe nga Bashki të tjera.

*"Qëllimi kryesor i punës sonë ka qenë ndërtimi i një modeli që do të mund të vlerësonte jo vetëm përmbushjen e premtimeve zgjedhore, por edhe të vlerësonte me objektivitet performancën e qeverisjes mjedisore në nivel vendor, për të shërbyer si një model për vlerësimin dhe rritjen e llogaridhënies në periudha apo bashki të tjera". Margarita Buxhaku, Drejtor Ekzekutiv i ACEG.*

Studimi "Barometri i performancës së Bashkisë Devoll" është një studim i kryer për herë të parë në zonën e Devollit, pas hyrjes në fuqi të reformës administrative territoriale në vitin 2015. Në terma konkretë, metodologjia mbështetet në dy shtylla kryesore: e para është vlerësimi me vërtetësi i performancës së qeverisjes në Bashkinë Devoll në 5 çështjet e përzgjedhura, ndërsa shtylla e dytë është ndjekja e një qasje pjesëmarrëse, pasi ka të bëjë me miratimin e përparësive të qeverisjes për mandatin e ardhshëm, të vendosura nga anëtarët e komunitetit. Roli i OSHC-së është mbledhja, vlerësimi, dhënia e përparësisë dhe miratimi i Letrës së Politikave për Përparësitë, mbështetur në komunikimet e drejtëpërdrejta me komunitetet vendase. Ky dokument mund të shërbejë si një mjet në duart e qytetarëve për më shumë llogaridhënie nga ana e të zgjedhurve në institucionet vendore.

Përmes vlerësimit të rreth 33 treguesve në 5 çështje të qeverisjes, raporti tregon vështirësitë e ndeshura nga Bashkia në trajtimin e situatave të reja për përmbushjen e kompetencave që përcaktohen nga Ligji 139/2015. Vështirësitë njihen si në lidhje me kualifikimet dhe kapacitetet njerëzore, ashtu edhe me kufizimet financiare.

Përveç qasjes monitoruese, faza e tretë e ndërhyrjes kishte të bënte me hartimin e Dokumentit të Përparësive Qeverisëse.

*"Roli kyç i OSHC-ve në bazë është ndërlidhja e nevojave të komuniteteve vendase me përparësitë e Qeverisjes Vendore. Ndaj, roli ndërmjetësues qendron në bërjen bashkë, strukturimin dhe përforcimin e zërit të komunitetit". Margarita Buxhaku, Drejtor Ekzekutiv i ACEG.*

Në këtë kontekst, Dokumenti konsiston në një listë përparësish të vendosura nga komuniteti i Bashkisë Devoll në të pesë çështjet e analizuar. Hartimi i dokumentit është bazuar në një proces pjesëmarrës, duke mbledhur nevojat e komunitetit në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Devoll, përmes takimeve të drejtëpërdrejta.

Pas mbledhjes dhe dhënies përparësi të nevojave, dokumenti iu paraqit Bashkisë, e cila e përvetësoi plotësisht. Përveç përparësive, projekti synonte edhe dhënien e mundësive të ndryshme për adresimin e disa prej çështjeve më të rëndësishme.

### **Përfundime:**

Edhe pse projekti përfaqëson një ndërhyrje në një bashki të caktuar, nga pikëpamja metodologjike, ai përfaqëson një rast suksesi në ndërtimin e një metodologjie vlerësimi objektiv, e cila është lehtësisht e përsëritshme në bashki të tjera, duke shërbyer kështu si një model për vlerësimin e performancës së qeverisjes, rritjen e llogaridhënies, si dhe nxitjen e një vendimmarrje me qasje pjesëmarrëse.

Barometri i Qeverisjes është një mekanizëm për vlerësimin e demokracisë vendore, i cili përdoret me mjaft efektivitet, duke sjellë një risi në pjesëmarrjen e OSHC-ve dhe të publikut në politikat e qeverisjes vendore mjedisore.


Në terma konkretë gjithashtu, projekti ka qenë i suksesshëm në ndërtimin e një qasje pjesëmarrëse për të përcaktuar përparësitë e qeverisjes vendore. Kjo ka sjellë një ndryshim të madh jo vetëm në mendësi, por edhe në sjelljen strukturore të qeverisjes vendore, duke i vendosur OSHC-të në një pozicion të natyrshëm si ndërmjetësues që ndërlidhin nevojat dhe përparësitë e komunitetit me objektivat qeverisëse.

Së fundmi, projekti mund të konsiderohet se ka sjellë një ndryshim të rëndësishëm, pasi ka ulur në bazë proceset demokratike të qeverisjes përmes konsultimeve të gjera me komunitetet.

## Nga Trashëgimia tek Fuqizimi

Këtu përgjithësohet trashëgimia e punës dhe mbështetjes së LevizAlbania në fushën e mbrojtjes së mjedisit në Shqipëri. Kjo mbështetje e vazhdueshme ka arritur të ndërhyjë në çaste vendimtare për të parandaluar shkatërrimin e mjedisit, për të ndaluar zhvillimin e projekteve, me ndikime negative të pakthyeshme në mjedis.

**Grafiku 3:** Shpërndarja gjeografike e projekteve mjedisore të mbështetura nga LA



Nxitja e aktivizmit qytetar për trajtimin e drejtë dhe me seriozitet të çështjeve të ndryshme mjedisore.

Ndryshimi i mendësisë dhe ndërtimi i rasteve shembull (precedentëve) që vendimmarrësit mund të kundërshtohen në gjykatë për çështje që lidhen me mjedisin.

Krijimi i një mjedisi mundësues për aktivizmin qytetar, duke krijuar copëza, në dukje të shpërndara në të gjithë Shqipërinë, por që të gjitha së bashku kanë ndihmuar në krijimin e një panorame të plotë të një qasje shumë të gjallë e vepruese të levizjes mjedisore në Shqipëri.

Sjellja për herë të parë e modeleve, puna e të rinjve në fushën e mjedisit, shpërndarja gjeografike, si dhe organizimi strategjik në rrjete dhe koalicione, të orientuara dhe të mbështetura nga LA, janë momente shumë të rëndësishme në kapitullin e trashëgimisë së programit në këta 8 vite.

Nxitja e grupeve informale për t'u organizuar në struktura më të qëndrueshme, të tilla si OSHC apo forume, ka qenë një tjetër arritje e dukshme e programit LA gjatë 8 viteve, duke ndihmuar në fuqizimin e shoqërisë civile dhe në aftësinë e saj për të ndërmarrë së bashku nisma të rëndësishme e të mprehta.

Tashmë, 8 vite nga nisja e këtij rrugëtimi, e gjithë përvoja e përfituar nuk është vetëm trashëgimi e asaj çfarë ka kaluar, por një mjet për fuqizim të mëtejshëm të shoqërisë civile dhe të levizjes mjedisore në Shqipëri.

Udhëzues, të dhëna, përvoja, histori, strategji, si dhe aksione së bashku me arritje, beteja të fituara, kuadër ligjor të përmirësuar dhe modele suksesi për më shumë llogaridhënie, përbëjnë me të vërtetë një mjet për përmirësim të mëtejshëm të shoqërisë civile mjedisore në vend.

Në këtë kontekst, projekti LevizAlbania, përveç se në fusha të tjera veprimi, ka një kontribut të jashtëzakonshëm në evolucionin dhe forcimin e lëvizjes mjedisore në Shqipëri.

## Përfundime

Përgjatë 8 viteve LevizAlbania ka kontribuar ndjeshëm në fuqizimin e lëvizjes mjedisore në Shqipëri, përmes mbështetjes së **rreth 70 projekteve**, që janë zbatuar nga OSHC, Grupe Informale dhe Individë, në më shumë se **54 bashki** të vendit.

**Gama** e projekteve të mbështetura nga LA në fushën e mbrojtjes së mjedisit ka qenë **mjaft e gjerë**, duke prekur çështje të lidhura me ruajtjen e natyrës, përmirësimin e mjedisit urban apo edhe çështje më strategjike si përmirësimi i kuadrit ligjor mjedisor.

Shumica e projekteve kanë adresuar **elemente të mjedisit urban**, ndjekur nga fushatat për mbrojtjen e mjedisit. Nismat me synim përmirësimin dhe forcimin e kuadrit mjedisor kanë qenë të pakta në numër, megjithatë, lobimi dhe advokimi kanë qenë qasje të përbashkëta.

Përgjatë viteve LevizAlbania ka nxitur **përfshirjen, bashkëpunimin, rrjetëzimin dhe fuqizimin**. Kështu, projekti ka zhvilluar dhe ka shtyrë përpara krijimin e koalicioneve dhe aleancave, në kuadër të projekteve që janë mbështetur.

Projektet e mbështetura nga LevizAlbania kanë sjellë **ndryshim në qasjen për përfshirjen e komuniteteve të vogla vendase** për zgjidhjen e problematikave mjedisore. Duke thyer apatinë dhe duke u organizuar për zhvillimin e fushatave pozitiviste, komunitetet kanë sjellë një model të ri të ndërveprimit qytetar. Bashkëpunimi dhe koordinimi në përdorimin e mjeteve të ndryshme, si protestat, fushatat publike, fushatat mediatike, proceset gjyqësore, kanë çuar po ashtu në zgjidhjen e plotë të problematikave mjedisore.

**Inovacioni, transparenca dhe fleksibiliteti** kanë qenë parimet udhëheqëse ndër vite për LevizAlbania. Mbështetja e individëve dhe grupeve informale, konkurset e ideve, si dhe një manaxhim fleksibel i granteve kanë qenë elementët kyç, që kanë siguruar dhënien e përgjigjes së duhur për nevojat që kanë dhe situatën ku janë shoqëria dhe mjedisi.

Në këtë pikëpamje, nismat e mbështetura nga LevizAlbania kanë rigjallëruar modelin e **veprimit qytetar**, si një levë e fuqishme për **ndryshimin e mendësisë**. Aksionet vullnetare në shkallë të vogël mund të kthehen në modele ndryshimi për çështje mjedisore më të mëdha e më të mprehta. Gërshetimi i përpjekjeve të aksioneve qytetare me elementë të advokimit dhe lobimit për ndryshime në kuadrin rregullator, përbën një ndryshim në qasjen për problematikat mjedisore.

Përveç mbështetjes financiare, LevizAlbania ka **zhvilluar mjete strategjike** si p.sh. Klinikat e Ligjit, Financat Vendore apo dhe Porta Vendore, për të ndihmuar bashkësinë e OSHC-ve dhe aktivistët në misionin e tyre. Këto mjete janë dhënë falas për grantmarrësit dhe për publikun.

LevizAlbania ka nxitur vazhdimisht ndërtimin e modeleve që garantojnë transparencë, drejtësi dhe pjesëmarrje qytetare në proceset qeverisëse demokratike në nivel vendor. Në këtë kontekst, projektet e mbështetura kanë sjellë **ndryshim në afrimin proaktiv të komuniteteve** nga ana e programeve të qeverisjes vendore, si dhe kanë zhvilluar gjithashtu mekanizma inovativ për vlerësimin e performancës së qeverisjes vendore.

Fakti që ka pasur një numër mjaft të lartë projektsh në fushën e mbrojtjes së mjedisit, tregon se ka ekzistuar nevoja për një qasje për mbështetje më strategjike e programatike nga ana e LevizAlbania. Për këtë duhet të ishte ndërtuar një **program i dedikuar për mjedisin**.

**Shpërndarja kapilare e granteve** dhe e mbështetjes nuk është detyrimisht tregues i suksesit. Mbështetja e strukturuar dhe e qendrueshme mund të jenë më të sukseshme në arritjen e qëllimeve. Në këtë kuptim, rrjetet e qendrueshme të ngritura sipas tematikave, do të ishin më të rekomandueshme se sa rrjetet e përkohshme të ngritura në bazë të Thirrjeve për Aplikime.

Nganjëherë është e vështirë të arrihen qëllimet e mëdha në një **projekt me kohë të kufizuar**. Kjo ka kufizuar OSHC-të në përcaktimin e objektivave afatshkurtër, që jo gjithmonë kanë kontribuar në pikturën e madhe. Për këtë, LA duhet të kishte ndjekur një qasje programatike në fazën e dytë të zbatimit, duke ndërtuar **struktura apo rrjetëzime tematike të OSHC-ve** me qëllime të qarta strategjike.

Gjatë viteve janë zhvilluar mjaft mjete komunikimi, por vihet re një mungesë koordinimi në mbledhjen e të gjithë këtyre njohurive dhe ofrimi i një platformë gjithëpërfshirëse për publikun. Ndaj, **kapitalizimi i njohurive** duhet të ishte përcaktuar si një objektiv i qartë që në fazë të hershme.

# Aneks 1

Listë e Projekteve Mjedisore të mbështetura nga LevizAlbania

Nr.	Titulli i Projektit	Zbatuesi	Thirrja për Aplikime	Kategorizimi
1	AKTIV - I	EcoAlbania	1	Ruajtje e Natyrës
2	Monitorimi i Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve (MIM), një instrument për nxitjen e reflektimit e qendrueshëm të qytetarëve të Bashkisë Kuçovë	Qendra për Qeverisje të Mirë	2	Mjedis Urban
3	Gjanica Lumi i Vdekur	Sokol Kosta	3	Mjedis Urban
4	Guroret, lobimi, advokimi nëpërmjet krijimit të grupeve ekologjike	Arjana Bardhi	3	Mjedis Urban
5	Monitorimi i shërbimit të ofruar nga "Eco Tirana", shoqëria Italo-Shqiptare e partneritetit publik-privat për realizimin e pastrimit të kryeqytetit	Qendra UET	3	Mjedis Urban
6	Platformë Multimedia për një qytet të pastër në Kavajë	Shoqata VISARE	3	Mjedis Urban
7	Advokim dhe lobim në Bashkinë Dibër për hartimin e një plani veprimi afatmesëm e afatgjatë për ruajtjen dhe manaxhimin e pyjeve të ulëta e të larta	Shoqata Runja	3	Ruajtje e Natyrës
8	AKTIV - II	EcoAlbania	4	Forcimi i Kuadrit Ligjor
9	Shkodra mbi dy rrota	Bepin Kolvataj	4	Mjedis Urban
10	Valbona ti je e jona	Sajmir Kalbaj	4	Ruajtje e Natyrës
11	Pa zhurmë	Ogerta Ujkashi	4	Mjedis Urban
12	Zëri yt – Zëri ynë	Gjelbërimi 2000	4	Mjedis Urban
13	Unë vendos për një të ardhme pa mërkur	CRCD	4	Mjedis Urban
14	Angazhim komunitar për një mjedis të pastër	Qendra Sociale për mbështetjen e Njerëzve	4	Mjedis Urban
15	Monitorim dhe vlerësim i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkitë Krujë, Përmet dhe Sarandë	Milieukontakt - Albania	4	Mjedis Urban
16	T'u japim zë qytetarëve – stimulimi i pjesëmarrjes publike mjedisore në Tiranë	Qendra Mjedisore per Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN)	4	Ruajtje e Natyrës
17	Monitorim, Llogaridhënie dhe Transparencë për manaxhimin më të mirë dhe zhvillimin e qendrueshëm të ekosistemit Prespë-Ohër	Shoqata Miqtë e Korçës	4	Ruajtje e Natyrës
18	Barometri i Bashkisë Devoll	ACEG	5	Forcimi i Kuadrit Ligjor
19	Monitorimi mjedisor në procedurat e prokurimit të Bashkive Korçë, Ersekë, Maliq	Qendra për Zhvillim dhe Integrim Rajonal - CDRI	5	Forcimi i Kuadrit Ligjor
20	Monitorim dhe vlerësim i ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Bulqizë	Shoqata e Ekspertëve të Rinj Mjedisor - SHERM	5	Forcimi i Kuadrit Ligjor
21	Durrësi Aktiv për një bregdet të pastër	Qendra Durrësi Aktiv	5	Mjedis Urban
22	Gjiri i Vlorës: Bukuria përballë ndotjes e larg vëmendjes	ECAT Tirana	5	Mjedis Urban
23	Instalacion: Ndal ndotjes në Fier!	Shoqata ANTIK	5	Mjedis Urban
24	Vlerësimi i cilësisë së mjedisit përmes monitorimit të ajrit, ujit dhe tokës në qytetin e Elbasanit	Abdulla Diku	5	Mjedis Urban
25	Jo në rrugë, jo buzë përrënjeve dhe lumit, jo çdo njësi me landfillin individual, për një mjedis të pastër, për një jetë të shëndetshme	Qendra për Studime e Zhvillim	5	Mjedis Urban
26	Të pastrojmë Maqellarën. Advokaci komunitare për ofrimin e shërbimit të pastrimit të mbetjeve urbane në Njësinë Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër	Behar Dema	5	Mjedis Urban
27	Dy liqene nën një fokus	Roland Beqiraj	5	Ruajtje e Natyrës
28	Zero Mbetje	IMMC	6	Forcimi i Kuadrit Ligjor
29	No Trash - Clean Ksamil	Shoqata "Levizja për Zhvillimin e Turizmit në Ksamil"	6	Mjedis Urban
30	Pastrimi i tabanit të detit Jon	Nisma e Luleve	6	Mjedis Urban
31	Qytetarët e Durrësit aktorë dhe faktorë në vendimmarrjen lokale	Qendra Durrësi Aktiv	6	Mjedis Urban
32	Ndryshojme Ambientin, Edukojme Komunitetin	Aurora Konomi	6	Mjedis Urban
33	Mbrojmë liqenin nga ndotja e mbetjeve urbane	Spartak Dikellari	6	Ruajtje e Natyrës



34	EQGj @Albania – Ekonomia qarkulluese dhe e gjelbër, mundësi për nxitjen e një shoqërie aktive dhe zhvillimin ekonomik në bashkitë Patos dhe Roskovec	Forumi Social – Ekonomik Forum – ASET	7	Mjedis Urban
35	Aftësimi dhe angazhimi për aksion komunitar në Bashkinë Belsh: Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit	Qerim Elezi	7	Mjedis Urban
36	Manza pa mbetje	Valdet Qyrfiçi	7	Mjedis Urban
37	Rini, Riciklim, Respekt - Ekosistemi i dashurisë për Mjedisin	Hand to Hand Against Nation Apathy	7	Mjedis Urban
38	"Dynamite" Ndal, unë jam "Drini i Zi"	Shoqata North Green	7	Ruajtje e Natyrës
39	Barrierat në komunitet: Efektet e ndërtimit të grupimeve të hidrocentraleve në statusin socio-ekonomik të popullsisë lokale	Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore - ACQJ	7	Ruajtje e Natyrës
40	Fol për ata që heshtin	Forumi Liqeni i Shkodrës	7	Ruajtje e Natyrës
41	"Dua ajrin tim" - Rritja e presionit qytetar për bashki më të pastra	Arti në duart e gruas	8	Mjedis Urban
42	Metamorfoza e Lumit Ishëm - Itinerari i së nesërme	ENFORCE – Albania	8	Mjedis Urban
43	Ujë vs Naftë	Shoqata Zharrëza	8	Mjedis Urban
44	Dëmtimi i mjedisit nga hedhja e mbeturinave për shkak të mos menaxhimit të tyre nga Njësia Administrative Velçan pjesë e Bashkisë Pogradec	Fabiol Rapçe	8	Mjedis Urban
45	Divjaka e shpëtuar nga të rinjtë	Vento Di Terra Albania	8	Mjedis Urban
46	Edukimi i fëmijëve mbi rëndësinë e procesit të riciklimit dhe ndarjes së mbetjeve në burim.	Anduana Shahini	8	Mjedis Urban
47	Përfshirja në iniciativa qytetare që kanë të bëjnë me çështjet e ambientit ku jetojmë	Xhoel Nikaj	8	Mjedis Urban
48	Qyteti i ëndrrave të mia	Grupi Informal i Kukësit	8	Mjedis Urban
49	Riciklimi i plastikës para se të kthehet në mbetje	Organizata për Menaxhimin e Destinacionit	8	Mjedis Urban
50	Riciklim dhe Traditë	Ariona Prenga	8	Mjedis Urban
51	Shëtis, fotoqarfoj, pastroj! Aktivizim qytetar përgjatë rrugëve rurale të Parkut Natyror Korab-Koritnik për t'a mbrojtur nga degradimin mjedisor	Qendra për Progres Rinor	8	Mjedis Urban
52	Të njohim Bulqizën duke e mbrojtur mjedisin	Shoqata Natyra dhe Turizmi në Bulqizë	8	Mjedis Urban
53	Aleanca Kundër Importit të Plehrave (AKIP)	AKIP	RR	Forcimi i Kuadrit Ligjor
54	Le të dëgjojmë komunitetin e Vlorës - Djegie naftë apo turizëm?!	Artes Ferrunaj	RR	Mjedis Urban
55	"Prapësim inceneratorëve, portave të importit të plehrave (PIPIP)"- Rasti i Fierit.	AKIP	RR	Mjedis Urban
56	Mbrojtja e Kanioneve të Osumit si Monument i Natyrës	Federata Shqiptare Rafting	RR	Ruajtje e Natyrës
57	Ndal HEC-eve në Parkun Kombëtar Lurë-Mali i Dejës	Dhimiter Koleci	RR	Ruajtje e Natyrës
58	Stop Urbanizimit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta	Albanian Ornithological Society - AOS	RR	Ruajtje e Natyrës
59	ENGONA - Rrjeti i organizatave mjedisore në Shqipëri	EcoAlbania	Grante Strategjike	Forcimi i Kuadrit Ligjor
60	Monitorimi i ndotjes akustike në zonat bregdetare	Milieukontakt - Albania	Grante Strategjike	Mjedis Urban
61	Rrjetëzimi dhe advokim për aksione komunitare të ruajtjes së burimeve natyrore lokale	Institute for Nature Conservation in Albania - INCA	Grante Strategjike	Ruajtje e Natyrës
62	Natyra jonë e bukur	Klubi Natyralisti	9	Ruajtje e Natyrës
63	E ardhmja e sigurt që rrjedh. Rritje e ndërgjegjësimit për Lumin Osum	Grupi Informal "Rini Aktive për Mjedisin "	9	Ruajtje e Natyrës
64	Lëviz kundër helmimit të faunës së egër	Conservation Youth Club Gjirokastra	9	Ruajtje e Natyrës
65	Nxitja e aksionit qytetar dhe mjedi sor tek të rinjtë	Ecovolis	9	Mjedis Urban
66	Kujtime nga Pylli i Fazanëve	Mësuesit për Ndryshim	9	Mjedis Urban
67	Lugina e Gjelit dhe Kodrat me Ullin mbuluar si një model për rinovimin e identitetit të vlerave mjedisore lokale në zonat rurale	Qendra ISBUR	9	Mjedis Urban
68	Ftesë për një Check in në #FushëStudën	Argela Llushi	9	Ruajtje e Natyrës
<b>Total</b>				<b>68</b>

